



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

STUDIM I POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE
ZHVILLIMORE TË TRANSMETIMIT
DIGJITAL NË VENDET E RAJONIT DHE
BASHKIMIT EVROPIAN

Raport hulumtimi

Nëntor, 2008
Prishtinë

*Ndalohet kopjimi dhe shfrytëzimi i këtij dokumenti pa
lejën e Komisionit të Pavarur të Mediave*

Përmbajtja

Abstrakt.....	4
HYRJE	5
HISTORIATI I TRANSMETIMIT DIGJITAL NË BASHKIMIN EVROPIAN.....	6
Kushtet e përgjithshme në Evropë dhe çështjet ligjore për digjitalizim	6
ROLI I UNIONIT NDËRKOMBËTAR PËR TELEKOMUNIKACION.....	8
RELACIONET: REGULLATOR – SUBJEKTI TRANSMETUES – RRJETI I TRANSMETIMIT – SHIKUES NË TRANSMETIMIN ANALOG DHE DIGJITAL.....	10
ROLI I RREGULLATORËVE LIGJOR – KORNIZA LIGJORE E KRIJUAR	11
Përmbledhje	15
Alokimi i frekuencave per Multipleks dhe menaxhim te multipleksit	16
Njoftimi i Publikut për procesin e digjitalizimit	16
ROLI I INDUSTRIJË SË TELEKOMUNIKIMIT	17
Mbështetja financiare.....	17
PROCESI I KALIMIT NË TRANSMETIM DIGJITAL – PËRVOJA NË SHTETE TJERA.....	20
Resurset e nevojshme për kalim: njerëzore dhe materiale – publike dhe private	20
PËRFUNDIM	22
Elemente tjera me ndikim në paraqitjen e DTT.....	23
Hartimi i strategjisë për kalim të transmetimit digjital	24
Rekomandimet:	26
FJALOR NË TERMINOLOGJINË E DIGJITALIZIMIT	27
REFERENCAT:.....	32

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është që të analizohen përvojat e vendeve të rajonit dhe të vendeve të Bashkimit Evropian në procesin e ndërprerjes së transmetimit analog dhe kalimit në transmetim digjital. Ky studim do t'i shërbejë Komisionit të Pavarur për Media (KPM-së) për të hapur debatin publik për hartimin e një strategjie mbi transmetimin digjital në Republikën e Kosovës. KPM ka kontraktuar kompaninë hulumtuese MPR Group që të kryej këtë hulumtim, mirëpo duke mos i lejuar të drejtën e shpërndarjes së këtij hulumtimi edhe institucioneve të tjera.

Hulumtimi është kryer përmes internetit dhe dokumenteve relevante që kanë të bëjnë me digjitalizimin e frekuencave, si strategji të ndryshme nga vendet e rajonit dhe dokumente të tjera të dala nga konferencat ndërkombëtare që janë zhvilluar nga kjo fushë. Gjithashtu, janë marrë për bazë edhe informacionet e drejtpërdrejta nga disa prej rregullatorëve të vendeve që kanë qenë të parapara për hulumtim. Të gjitha këto materiale janë analizuar dhe janë nxjerrë përvojat më të mira dhe më të përshtatshme që janë të aplikueshme dhe të mundshme për Republikën e Kosovës.

Prandaj, mendojmë që ky hulumtim ka arritur të realizojë qëllimin e KPM-së për hapjen e një debati publik për hartimin e një strategjie të mirëfilltë mbi transmetimin digjital në Republikën e Kosovës dhe besojmë që është një udhërrëfyes i mirë drejt hartimit të strategjisë.

HYRJE

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë filluar ndaljen e rrjetit të frekuencave analoge televizive duke filluar kalimin në transmetime digjitale, në përputhshmëri me qëllimin e Bashkimit Evropian për një kalim total në transmetim digjital në tërë Evropën deri në vitin 2012.

Transmetimi televiziv digjital ka shumë përparësi krahasuar me teknologjinë analoge të transmetimit. Elementi kryesorë lidhur me këtë zhvillim është fakti se teknologjia digjitale për transmetim shfrytëzon gjithashtu brezin frekuencor, mirëpo me një efikasitet shumë më të lartë se sa që shfrytëzohet nga transmetimi analog. Prandaj, kjo nënkupton se qytetarët kanë zgjedhje më të gjerë të programeve dhe që më shumë kompani ofruesish të programeve kanë mundësi të arrijnë tek publiku.

Krahasuar me transmetimin analog, i cili siç u përmend edhe më lartë nxen shumë më shumë hapësirë gjatë transmetimit në brezin frekuencor, në transmetimin digjital pranimi i sinjalit paraqet më pak apo fare interferenca, ndërsa pamja vizuale dhe kualiteti i zërit është e nivelit shumë më të lartë. Gjithashtu, nevojat për shpenzimin e energjisë elektrike janë shumë më të vogla për transmetimin digjital, dhe kjo nënkupton se edhe kostoja për funksionalizimin e transmetimit digjital është shumë më e ulët dhe ndikimet përmes valëve radio televizive janë shumë më të ulta në mjedisin ku jetojmë.

Teknologjia digjitale gjithashtu rritë mundësinë e kombinimit të programeve televizive me shërbime tjera shtesë, që do të ketë rëndësi të madhe për programet edukative dhe për përmirësim të mundësisë që njerëzit me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në programe, duke përdorur për shembull, interpretimin për ata me pamje të dobësuar, duke reduktuar zhurmën në prapavi për ata me dëgjim të dobët, ose gjuhën e shenjave për të shurdhërit etj.

Kjo është njëra prej arsyeve kryesore pse bota e televizionit, si i gjithë prodhimi dhe shpërndarja elektronike televizive, po kalon në teknologji digjitale.

Procesi i kalimit në transmetim digjital në Evropë është në progres, ku disa vende të Bashkimit Evropian tanimë veq e kanë përfunduar procesin e digjitalizimit në tërësi. Gjithashtu, edhe nëpër botë shtetet kanë lançuar shërbimet e tyre digjitale të televizionit tokësor (DTT)¹ dhe kanë filluar planifikimin për të ndaluar rrjetet analoge. Megjithatë, ndërprerja e transmetimit analog nuk është e lehtë, si nga aspekti teknik, po ashtu edhe nga aspekti i krijimit të infrastrukturës ligjore.

¹ DTT, sistemi DVB-T ose DVB-H, metoda të transmetimit digjital, ku sinjalet bazike të audios dhe videos janë të konvertuara, rregulluara dhe të koduara në një format digjital dhe të përhapura si të tilla; kompresimi mundëson një kanal të frekuencave me gjerrësi 8 MHz – VHF dhe 7 MHz – UHF – për të kryer tri deri në pesë programe të ndryshme, metoda digjitale ka një përfitim transmetimi prej 10 dB krahasuar me atë analog, për shkak të ndjeshmërisë më të madhe të resiverëve digjital dhe procedurave të marrjes së sinjalit (modulimi, raporti i kodimit, ruajtja e intervaleve, kodimi), mundëson marrje mobile; Marrja kërkon një kulm, Brenda apo jashtë, mbulimi i një zone më të madhe ka nevojë për një rrjet që mund të operojë si Single Frequency Network SFN (rrjet i vetëm i frekuencave) ose Multi Frequency Network MFN (Rrjet të shumëfishtë të frekuencave; e fundit është më efikase por është më e vështirë për t'u planifikuar dhe implementuar)

Përfundimi i transmetimit të shërbimeve analoge mund të ketë pasoja të tmerrshme nëse shikuesit nuk janë të përgatitur në mënyrë adekuate për të pranuar sinjalin digjital nëpër TV, kështu që një numër i madh i tyre mund të humbin qasjen në programet televizive. Kështu që asnjë vend nuk do të dëshirote të rrezikojnë heqjen e të drejtës së shikuesve në TV programe dhe për këtë arsye secili institucion shtetëror përgjegjës do të sigurohet që të ndërmerren të gjitha masat e duhura për t'i ofruar qasje në transmetim digjital të gjithë qytetarëve. Por kjo gjë do të kërkojë planifikim të kujdesshëm dhe përfshirje të tërë industrisë së transmetimit/mediave, dhe të autoriteteve rregullative në veçanti .

Përvojat e shteteve që kanë kompletuar ndërprerjen e transmetimit analog ose kanë ndërmarrë planifikim të gjerë për të realizuar këtë proces, mund të japin mësim të dobishme për shtetet që janë në fazë fillestare të procesit planifikues, që në këtë fazë është edhe Republika e Kosovës.

HISTORIATI I TRANSMETIMIT DIGJITAL NË BASHKIMIT EVROPIAN

Kushtet e përgjithshme në Evropë dhe çështjet ligjore për digjitalizim

Në shtator 2003, Komisioni Evropian publikoi një komunikatë për kalimin nga transmetimi analog në digjital (nga “switchover” digjital në “switch=off” analog), që ka paraqitur beneficionet e kalimit në transmetim digjital, ka hulumtuar disa direktiva të politikave të rregullimit të transmetimit dhe ka nxitur një debat rreth direktivave të Bashkimit Evropian, për vlerën dhe përdorimin e ardhshëm të spektrit të lëshuar nga tërheqja e transmetimit televiziv tokësor analog.

Në nëntor 2003, Grupi për Politika i Bashkimit Evropian² për Spektrin Frekuencor (RSPG origjinal), ka publikuar një opinion rreth mënyrës se si kalimi në transmetim tokësor digjital, do të ketë ndikim në spektrin frekuencor. Raporti zhvillon pozita duke pasur parasysh një analizë të planeve për kalim, të shteteve anëtare, të publikuara në kornizë të e-Europe³, planin e veprimit i vitit 2005, dhe opinionet e RSPG-së. Komunikata gjithashtu tregon të gjeturat e studimeve të kryera për shërbim të Komisionit të BE-së për reklamim dhe liberalizim të valëve, dhe për menaxhim të valëve në fushën e transmetimit.

² http://ec.europa.eu/information_society/policy/radio_spectrum/ref_documents/index_en.htm

³ Plani i veprimit për zhvillim të shoqërisë informative në Evropë – eEurope 2005 – është miratuar në qershor 2002 në Sevilla, ka pasur për qëllim zhvillimin e e-biznesit, e-mësimin, e-shëndetësisë, dhe e-administratës, në bazë të lidhjeve të sigurta frekuencave; në pikën 3.1.4 të Planit të Veprimit në lidhje me masat për përdorim të lidhjeve të frekuencave, masat janë të listuara për valët e frekuencave të radios, përdorin lidhjet e frekuencave në rajone më pak të populluara, eliminimin e barrierave për përdorim më të gjerë të frekuencave, përmbajtjes për platforma të ndryshme dhe kalimin në transmetim digjital; parasheh një vlerësim të situatës në tregje të rëndësishme në shtetet anëtare dhe miratimin e planeve kombëtare të implementimit, për kalimin në transmetim digjital; plani i veprimit eEurope 2005 përfundon në fund të vitit 2005, për t'u zëvendësuar nga korniza strategjike i2010

Qëllimi primar i kalimit në transmetim digjital është krijimi i mundësisë që të rritet gjerësia apo spektri i frekuencave sepse ajo tani për tani, me që është një burim i limituar, përmes transmetimit analog nuk ofron hapësirë të mjaftueshme për transmetim, sidomos në atë televiziv. Kështu që krahasuar me transmetimet digjitale, transmetimet analoge kanë nevojë për më shumë gjerësi të spektrit frekuencor.

Në mungesë të tanmsetimit digjital, gjerësia ekzistuese e frekuencave shumë shpejt mund të jetë e stërbushur. Kështu, kjo kushtëzon rritjen e kostos së transmetimit si dhe paraqet pengesa të konsiderueshme për investime në teknologji të reja. Ndërprerja e transmetimeve analoge dhe zëvendësimi i tyre në transmetime digjitale duke përdorur disa lloje të teknologjive dhe platformave të ndryshme transmetimi, do të rrisë në masë të konsiderueshme gjerësinë e frekuencave, duke përbushur qëllimet e BE-së.⁴

Një karakteristikë speciale e kësaj objektive shtrihet në zhvillimin e vazhduar të shoqërisë së informuar me informata të bazuara në dituri, me qasje të hapur për të gjithë konsumatorët dhe me qasje jo-diskriminuese për shërbimet për transmetim të dhënave nga ana e ofruesit të shërbimit. Problemi i një ndarjeje digjitale, e cila rezervon përfitimet e shoqërisë së informuar dhe të rrjetëzuar për një të ashtuquajtur “info elitë” dhe ndanë pjesë të mëdha të shoqërisë nga zhvillime të tilla, mund të shmanget duke krijuar infrastrukturë e cila iu mundëson të gjithë konsumatorëve qasje në shërbime dhe në përmbajtjen audiovizuale të komunikimeve.

Në këtë kontekst, digjitalizimi i transmetimit luan një rol tejet të rëndësishëm si mënyrë e transportimit të përmbajtjes dhe të dhënave në shoqërinë informative. Migrimi nga teknologjia analoge në atë digjitale gjithashtu jep shumë më shumë kapacitet transmetimit në të gjitha platformat (tokësore, satelitore dhe kabllore). Në këtë kontekst, digjitalizimi i dërgimit të transmetimit luan një rol veqanërisht të rëndësishëm si mjet i transportimit të përmbajtjes programore dhe shërbimeve për të dhëna, në shoqërinë informative.

Migrimi nga teknologjia analoge në digjitale gjithashtu jep shumë më shumë kapacitet për të gjitha platformat (tokësore, satelitore dhe kabllore) dhe mundëson një përdorim në efikas të spektrit të frekuencave, që është në vecanti relevant në transmetim tokësor.

Kjo do të ketë efekte positive të ofruesit por edhe të konsumatorët. Për përmbajtjen dhe ofruesit e shërbimeve, shpërndarja do të bëhet më e lehtë dhe më pak e kushtueshme në aspektin financiar në eopkën digjitale, për shkak të disponueshmërisë së kapaciteteve më të mëdha të të dhënave. Pas migrimit të transmetimit të të dhënave digjitale, konsumatorët mund të presin shumë më shumë kanale si dhe lloje të reja të përmbajtjes dhe shërbimeve.

⁴ Digital Switchover in the European Union, European Satellite Operators Association “ESOA”; 4th December 2006, Riga; www.esoa.net; http://www.esoa.net/v2/events/assets_20061204_DigitalSwitchover/20061204_DigitalSwitchover_Presentation_ESOA.pdf

ROLI I UNIONIT NDËRKOMBËTAR PËR TELEKOMUNIKACION

Unioni Ndërkombëtar për Telekomunikacion⁵ (UNT) është agjenci udhëheqëse nën Kombet e Bashkuara, përgjegjëse për komunikim dhe teknologji informative, si pikë kryesore për shërbime dhe zhvillim të rrjeteve për sektorin qeveritar dhe atë privat. Për më shumë se 140 vite, UNT ka koordinuar dividentin⁶ global të përdorimit të spektrit të frekuencave të radios, ka promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar për përcaktim të orbitave satelitore, ka punuar në përmirësim të infrastrukturës së komunikimit në botën e zhvilluar dhe ka vendosur standarde në të gjithë botën, që garantojnë qëndrueshmëri në interkoneksione në sistemin e gjerë të komunikimit.

Marrëveshja e Gjenevës 2006: Unioni Ndërkombëtar për Telekomunikacion ka miratuar një plan të frekuencave për shërbim të transmetimit në vitin 2006, gjë që ka rëndësi bazike për transmetimin tokësor digjital për audio dhe video transmetim. Marrëveshja Gjeneva 2006 (GE-06) rregullon përdorimin e frekuencave tek transmetuesit e Evropës, Afrikës dhe pjesë të Azisë⁷. Kjo marrëveshje krijon dy plane të ndara për mjedis analog dhe digjital në rajonet e lartpërmendura të botës. Pra, marrëveshja GE 06 është një traktat obligues ndërkombëtar, i cili është nënshkruar nga administratat nacionale dhe i regjistruar në Kombet e Bashkuara.

Menaxhimi i frekuencave para GE-06: Në Evropë dhe disa pjesë të Azisë, GE – 06 zëvendëson Marrëveshjen ekzistuese të Stokholmit (ST-61)⁸ e cila ka rregulluar përdorimin e frekuencës në mjedis të transmetimit analog. Për arsye se marrëveshja ST-61 gjithashtu ka rregulluar edhe përdorimin e frekuencave për shërbimet në shiritet I dhe II, disa pjesë të ST-61 dhe të marrëveshjeve tjera pasuese, mbeten ende në fuqi. Përderisa ST-61 ka alokuar vetëm 5,300 nga kërkesat e shteteve, ajo ka mundësuar fleksibilitetin e nevojshëm për të lejuar përfundimisht edhe funksionimin e 80,000 transmetuesve analog. Shpresohet që GE-06 gjithashtu do të lejojë fleksibilitet të tillë për nevojat e së ardhmes.

Në vitin 2004, sesioni i parë i Konferencës Rajonale për Komunikim me Radio (RRC) mbledhi takim për tri javë në Gjenevë, për të vendosur parametrat planifikuese për një mjedis transmetues të tërin digjital. Sesioni i dytë mbledhi takim në vitin 2006, për të zhvilluar planin digjital si dhe planin analog, bazuar në revidimet që i ishin bërë ST-61 dhe GE-89⁹. Ajo u konkludua me sukses me miratimin e Marrëveshjes GE-06.

⁵ <http://www.itu.int/net/about/index.aspx>

⁶ Termi divident ka të bëjë me ndarjen e frekuencave, pra i quajtur dividenti i spektrit - frekuencat ose spektri që do të lëshohen pas kalimit nga transmetimi analog në atë digjital, për shkak të 3-6 palë rritjesh në efikasitetin në përdorim të spektrit, dhe kompresionit të të dhënave digjitale. Një term i paraqitur nga Komisioni Evropian gjatë paraqitjes së qasjes së tregut, për diskutim të spektrit të rekuencave.

⁷ http://www.digitag.org/DTTResources/IBC06/Digital_future.pdf

⁸ <http://www.itu.int/ITU-R/conferences/rrc/rrc-06/revieëST61/index.asp>

⁹ <http://www.itu.int/ITU-R/terrestrial/broadcast/plans/ge89/index.html>

Ndërprerja e transmetimit analog: Marrëveshja GE-06 cakton datën precize më 17 qershor 2015 si fundi i periudhës së tranzicionit të transmetimit analog në atë digjital. Kjo nënkupton që pas kësaj kohe, shtetet nuk do të kenë më nevojë të mbrojnë shërbimet analoge nga shtetet fqinje dhe mund të fillojnë lirshëm të përdorin frekuencat e caktuara për secilin shtet veç e veç në GE-06, për shërbimet e tyre digjitale.

Megjithatë, një gjë e tillë do të kërkojë marrëveshje paraprake të shteteve që implikohen nga një veprim i tillë. Shtetet e prekura janë të definuara si ato brenda një hyrje të planit, që kanë nevojë të kenë marrëveshje para implementimit të një funksioni/ndarjeje. Fundi i periudhës së tranzicionit jo domosdoshmërisht nënkupton që ndalja analoge do të ndodhë në tërë shtetin. Por nënkupton, megjithatë që shërbimet analoge nuk do të jenë më të mbrojtura e as në dispozicion brenda kufinjve, dhe kështu do të mund të shërbenin si një stimul për ndalje të shërbimeve analoge në tërë shtetin e caktuar.

Në përforcim të Vendimit të Konferencës rajonale të UNK-së për komunikim me radio (më tutje të referuar si “Konferenca ITU RRC -04/06”) që është mbajtur në vitin 2004, disa aktivitete kanë ndodhur sipas afateve kohore që janë miratuar gjatë gjysmës së parë të kësaj konference. Administrimi i telekomunikacionit i shteteve individuale ka ushtruar nevojat e tyre për të ashtuquajturin ushtrim planifikues, në mënyrë që ata të mund të vlerësohen nga pikëvështrimi i përputhshmërisë.

Për shkak të vonesave në zgjidhjet e proceseve të ndryshme politike, Republika e Kosovës në këtë aspekt ka mbetur mbrapa dhe ende nuk ka filluar të punojë në këtë proces zhvillimor. Problemi kryesorë për ngecje ka qenë fakti se Republika e Kosovës, për shkak të statusit politik të pazgjidhur, nuk ka qenë e mundur të merr pjesë në konferencën e ITU-së të mbajtur në Gjenevë në vitin 2006. Kjo konferencë (GE 2006) ka qenë shumë e rëndësishme lidhur me koordinimin e spektrit frekuencor, në të cilën janë bërë alokimet e frekuencave për transmetim digjital në tërë territorin e Evropës, përfshirë edhe Republikën e Kosovës.

Në mungesë të përfaqësuesve nga Republika e Kosovës, lidhur me alokimin e frekuencave në spektrin frekuencor të Republikës së Kosovës kanë vendosur përfaqësues nga shteti fqinj Serbia. Për këtë fakt, Republika e Kosovës është dëmtuar në këtë proces, prandaj zgjidhja më e mirë është që përfaqësues të Republikës së Kosovës të inicojnë procesin e aplikimit për anëtarësim në ITU sa më parë të jetë e mundur dhe të kërkojnë ri-shikimin e ndarjes së allotmenteve të cilat janë rezultat i marrëveshjes GE 06.

RELACIONET: REGULLATOR – SUBJEKTI TRANSMETUES – RRJETI I TRANSMETIMIT – SHIKUES NË TRANSMETIMIN ANALOG DHE DIGJITAL

Transmetimi digjital televiziv tanimë ekziston, apo është në përgaditje e sipër në disa shtete në Evropë, ndërsa për të sjellë një raport studimi përmes një analize të përvojave në vendet e Bashkimit Evropian dhe në vendet e rajonit, i cili do të jetë i shfrytëzuar për përgaditjen e Republikës së Kosovës për fazën e digjitalizimit, janë zgjedhur vendet e paraqitura më poshtë, ku në këtë studim do të merren për bazë zhvillimet relevante për secilin shtet veç e veç gjatë përgaditjes së procesit të digjitalizimit. Pra, vendet nga të cilat janë marrë përvojat e tyre rreth procesit të kalimit të transmetimit nga ai analog në atë digjital, në këtë studim janë:

- | | |
|------------------------------|----------------------------|
| 1. Gjermania | 7. Maqedonia |
| 2. Franca | 8. Shqipëria |
| 3. Italia | 9. Mali i Zi |
| 4. Mbretëria e Bashkuar (UK) | 10. Bosnja dhe Hercegovina |
| 5. Suedia | 11. Kroacia dhe |
| 6. Sllovenia | 12. Serbia |

Nga vendet e përzgjedhura për studim, është vetëm Suedia e cila ka përfunduar procesin e ndërprerjes së transmetimit analog duke filluar me transmetim digjital në tërë vendin. Ndërsa, një pjesë tjetër e vendeve të zgjedhura për këtë studim, janë në proces të përfundimit të ndërprerjes së transmetimit analog dhe pjesërisht kanë filluar transmetimin digjital (Franca, Austria, Mbretëria e Bashkuar, Italia, Gjermania). Sllovenia dhe Mali i Zi e kanë hartuar strategjinë për kalimin në transmetim digjital, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Maqedonia, Kroacia dhe Serbia janë në proces të hartimit të strategjisë për kalim në transmetim digjital dhe në fazën e krijimit të infrastrukturës liggjore në përgjithsi.

Bazuar në përvojat e disa vendeve të paraqitura më lartë, me kalimin e transmetimit digjital do të ndryshojnë edhe relacionet mes rregullatorit dhe subjektit transmetues, ku në mes të tyre do të paraqitet nevojë të inkluarohet edhe operatori i multipleksit, i cili do të menaxhojë në aspektin teknik të realizimit të transmetimit të programeve. Pra, përveq rregullimit të aspektit përmbajtësor të programit, rregullatori do të rregullojë edhe aspektin teknik dhe ndarjen e hapësirës për transmetim nga operatori i multipleksit. Kjo do të ketë ndikimin më të madh në alokimin e kapacitetit të spektrit frekuencorë tek operatorët e multipleksit¹⁰.

¹⁰ Pjesë e sistemit digjital të transmetimit në telekomunikacion, që kombinon shumë kanale të futura – programe, që pastaj i transmeton ato në një sistem të përbashkët të transmetimit; në terminologji DVB, kjo i referohet të gjithë sistemit që operon në një kanal të vetëm të frekuencave në një rrjet SFN ose MFN dhe që ofron katër ose më shumë programe të ndryshme, varësisht nga lloji i kompresimit (MPEG2 apo MPEG 4).

Megjithatë, modeli rregullativ i zgjedhur nga shtetet e ndryshme për alokim të kapacitetit të frekuencave digjitale është konsideruar gjithashtu si faktor që afekton zhvillimin e DTT-së.

Qasje shumë të ndryshme rregullative janë miratuar dhe në shumicën e rasteve, si në Gjermani, Mbretëri të Bashkuar, Itali, etj., kapaciteti është i alokuar në një ose më shumë operatorë multipleks të rrjetit. Në raste tjera (p.sh. Suedia), kapaciteti është i alokuar direkt te kanalet. Në vlerësim të modelit rregullativ të menduar, ajo cka duket të jetë relevante, më shumë se kujt i është dhënë kapaciteti, është mënyra e qasjes në këtë kapacitet të rregulluar.

Duket të ketë dy qasje të ndryshme. E para është që kanalet radhiten si rezultat i një përzgjedhjeje të bërë direkt nga rregullatori, përmes procedurave publike që janë shumë të ngjashme me ato të përdorura në mjedisin analog. Kështuqë në këtë rast, nëse frekuencat janë të alokuara direkt te transmetuesi ose të operatorët e rrjetit, radhitja e kanaleve në kapacitet, është e predefinuar nga rregullatori.

Në qasjen e dytë, kapaciteti menaxhohet si tërësi, nga operatorë multipleks i rrjetit, i cili është relativisht i lirë në përdorim të kapacitetit dhe përzgjedhje të kanaleve që janë pjesë e radhitjes. Në këtë rast, disa kufizime ose detyrime që janë të obligueshme në mënyrë që të ruhen objektivat e interesit publik, sic janë diversiteti dhe pluralizmi medial.

Në këtë mënyrë, subjekti transmetues analog, me kalimin e transmetimit digjital kryesisht do të merret me ofrimin e programit në aspektin përmbajtësor. Përcaktimi se kush do të jetë operator i multipleksit, në bazë të përvojave në vendet tjera (Suedi, Francë, Mbretëri e Bashkuar, Itali, Slloveni etj) duhet të sigurohet me kujdes të veçantë nga rregullatori që në asnjë mënyrë të mos ketë efektë monopolizimi apo diskriminimi.

ROLI I RREGULLATORËVE LIGJOR – KORNIZA LIGJORE E KRIJUAR

Në bazë të analizës së dokumentave, respektivisht të strategjive, pothuajse në secilin shtet rol të rëndësishëm në inicimin e procesit të digjitalizimit kanë pas rregullatorët e transmetimit, duke propozuar fillimisht krijimin e grupeve punuese duke përfshirë të gjithë akterët relevant si nga sektori publik, po ashtu edhe nga ai privat në krijimin e infrastrukturës ligjore duke nxjerre ligje mbi transmetimin digjital apo edhe akte tjera nënligjore për rregullimin e transmetimit digjital. Më poshtë do të paraqiten në mënyrë përmbledhëse përvojat që mund të merren si më relevante në disa nga vendet e përzgjedhura për studim.

Shqipëria: Duke u ballafaquar me presionin në rritje të planeve të deklaruara për fillim të televizionit digjital, autoriteti rregullativ ka punuar një draft strategji për kalimin në transmetim digjital dhe pastaj edhe për ndryshimin e ligjit për transmetim. Draft strategjia jep një analizë të shkurtër të situatës ekzistuese në aspektin e planit të frekuencave dhe zhvillimit të sektorit televiziv, një mekzaminim të të mirave dhe mangësive të paraqitjes së televizionit digjital, skenaret potenciale, kriteret për licensim, dhe plani potencial për kalim, si dhe rekomandimet për sukses.

Shqipëria planifikon që në bazë të katër skenareve të ndryshme në lidhje me kalimin në transmetim digjital të ndërpresë transmetimi analog:

1. Skenari i parë mundëson mbrojtje maksimale të frekuencave analoge, duke i lënë operatorëve të përcaktojnë kur ata janë të gatshëm të kalojnë në transmetim digjital.
2. Skenari i dytë gjithashtu sygjeron mbrojtjen e frekuencave analoge, por vetëm për një periudhë të caktuar kohore, e cila duhet të definohet. Për më tepër, do të pasonte hyrja e operatorëve të rrjetit digjital, një nga një.
3. Skenari i tretë nuk jep ndonjë përpjekje për të mbrojtur frekuencat e rrjeteve ekzistues, por në vend të asaj, të gjitha frekuencat analoge do të kthehen në digjitale.
4. Skenari i katërt përfshinë studimin e menjëhershëm dhe ndërtimin e planit të frekuencave digjitale, pa pasur fare konsideratë për rrjetin ekzistues analog.

Pas realizimit të këtyre skenarëve, parashihet që kalimi në transmetim digjital dhe ndërprerja e atij analog në periudhën kohore 2016 – 2020, megjilatë, pa caktuar ndonjë sasi të depërtimit të transmetimit digjital në vend. Sidoqoftë, në draft - strategjinë e tanishme duket të mos ketë vizion të qartë për rëndësinë e përmbajtjes dhe imponim të rregullave të qarta dhe të caktuara mbi të.

Maqedonia: Me që ekziston Ligji për Transmetim, në Maqedoni ka filluar përpilimi i strategjisë për kalim në transmetim digjital, ndërsa bartësi i këtij projekti është Këshilli Transmetues. Në këtë bazë, draft strategjia përfshinë të gjitha analizat e nevojshme të procesit të digjitalizimit, duke filluar me qëllimin, nevojat për implementim, përfitimet, efektet, aspektet financiare, si dhe vendosjen e pikave kyçe për tranzicion nga transmetimi analog në digjital deri në pjesën finale të saj.

Mali i Zi: Autoritetet rregullative për transmetim dhe telekomunikacion, brenda kompetencave të tyre dhe ushtrimit të bashkëpunimit të dyanshëm, rolin kryesorë e kanë për të definuar dhe për të kryer alokimin e frekuencave në mënyrë transparente, efikase dhe me kohë. Kontributi i tyre qenësor është promovimi i procesit dhe sigurimi i një forumi të gjerë për të shkëmbyer opinione, njohje të problemeve dhe zgjidhje të mundshme.

Që nga vitit 2002, sektori i transmetimit është i rregulluar me Ligjin për Transmetim. Segmente tjera të rëndësishme në aspektin rregullativ janë: Ligji për Shërbimet Publike të Transmetimit “Radio e Malit të Zi” dhe “Televizioni i Malit të Zi” dhe Ligji për Media, të gjithë të miratuar në vitin 2002.

Pritet që deri në fund të vitit 2008, këto ligje të rishikohen duke miratuar zgjidhje të reja ose të ndryshuara për të mundësuar dhe stimuluar procesin e transmetimit nga sistemi analog i transmetimit në digjital. Pranimi i tipareve specifike në proces, vendimi për intervenim legjislativ duhet të miratohet sa më heret të jetë e mundur, për të rezultuar në:

- Caktim të qartë të datës për ndërprerje të transmetimit analog;

- Të drejta të qarta dhe obligime për entitete të caktuara që kanë për detyrë planifikimin, financimin, implementimin dhe promovimin e digjitalizimit;
- Një kornizë e cila do të njeh rezultatet e deritanishme në zhvillimin e sektorit dhe në mundësimin e harmonizimit të mëtutjeshëm me Këshillin e Evropës dhe standardet e Bashkimit Evropian në sektorin e shërbimeve audio-vizuele, si dhe në sektorin e komunikimeve elektronike.

Duke filluar nga resurset humane dhe teknike për kryerje të procesit, organet rregullative gjithashtu do të luajnë rol të rëndësishëm në vlerësimin kualitativ dhe në kohë të procesit. Njohja e sasisë së kohës në dispozicion (deri në fund të vitit 2012) brenda së cilës të gjitha fazat e rëndësishme duhet të implementohen para ndaljes së transmetimit analog, autoritetet kompetente shtetërore dhe organet rregullative obligohen të sigurojnë kordinim maksimal të aktiviteteve të tyre, për të qenë në gjendje të arrijnë afatet.

Serbia: Duke marrë parasysh se Ligji ekzistues për rregullimin e transmetimit nuk mirret me transmetim digjital, në Serbi është paraqitur nevoja të rregullohet transmetimi digjital në mënyrë gjithëpërfshirëse përmes një ligji të ri, apo me një ndryshim të atij ekzistues, sepse ndryshe nga transmetimi analog, ai paraqet një sistem në zingjirin e të cilit, prej prodhimit të programeve deri të transmetimi janë disa pjesëmarrës (*ofruesi i përmbajtjes, operatori i multipleksit, ofruesi i transmetimit*). Pra, relacionet ofrues i përmbajtjes, operator i multipleksit dhe ofrues i transmetimit janë në proces të definimit dhe kjo parashihet të bëhet në bazë të ligjit i cili, siq theksohet edhe më lartë do të nxirret i ri apo edhe të amandamentohet ai ekzistuesi.

Në këtë fazë, autoriteti rregullativ ka për obligim iniciimin dhe mbështetjen e procesit të digjitalizimit, ku përmes një planifikimi të detyrave, për kanale speciale televizive që kanë për qëllim iniciimin e transmetimit eksperimental digjital. Gjithashtu, autoriteti rregullativ obligohet të mundësojë, përmes dekreteve të veta, qasje për të gjithë transmetuesit e interesuar për kanale eksperimentale digjitale. Sidoqoftë, Serbia tani është në fazën e përgaditjes së hartimit të strategjisë për digjitalizim.

Sllovenia: Roli i rregullatorit në Slloveni kryesisht ka të bëjë me përgaditjen e tenderëve për operatorët e Multipleksit dhe për licencimin e programeve në rrjetin DTT. Gjithashtu bënë monitorimin e rrjetit DTT, vendos për datën e tranzicionit të transmetimit, definon ndërprerjen e transmetimit analog në aspektin gjeografik. Ndërsa, sa i përket kornizës ligjore në Slloveni tani më veq ekziston ligji për transmetimin digjital, e gjithashtu janë amandamentuar edhe ligji për transmetime elektronike, ligji për media si dhe është përpiluar strategjia për kalimin e transmetimit digjital.

Mbretëria e Bashkuar: Qëllimi i kalimit në program digjital është që të gjitha televizionet në Mbretërinë e Bashkuar të kalojnë në digjital deri në fund të vitit 2012; në një mënyrë, kjo e bënë atë përvojë të thjeshtë dhe pozitive për shikuesit, dhe jep asistencë të duhur për ata që ju nevojitet. Ndërsa, roli kryesorë i rregullatorit (*Ofcom*) në Mbretërinë e Bashkuar është kryesisht që të sigurohet se regjimi rregullativ të japë siguri për licencat në lidhje me obligimet e tyre për

implementim të kalimit të transmetimit nga ai analog në atë digjital. Menaxhimi i procesit të digjitalizimit bëhet nga Digital UK¹¹, një kompani jo-fitimprurëse për të udhëhequr me procesin e digjitalizimit në Mbretërinë e Bashkuar, ndërsa roli i Ofcom-it përfshihet në licencimin e subjekteve transmetuese, planifikimin e spektrit frekuencor dhe ofron ndihmë në qështjet e mbulueshmërisë .

Gjithashtu, autoriteti rregullativ rol të rëndësishëm do të ketë në krijimin e mundësive që plani i frekuencave për kalim në digjital të kompletohet me kohë dhe që marrëveshjet e nevojshme ndërkombëtare (nga RRC dhe përmes negociatave bilaterale me shtetet fqinje) të sigurohen, si dhe të krijojë bazë për një konkurrencë të drejtë dhe efikase në mes të gjitha platformave televizive digjitale.

Gjermania - Kushtet e kornizës ligjore: Roli i Autoritetit rregullativ për Telekomunikacion dhe Postë ka krijuar një bazë për alokime të frekuencave në legjislacionin të telekomunikimit dhe ka kryer procedurën për dhënie të frekuencave për transmetim të programeve transmetuese tokësore digjitale dhe shërbime tjera të telekomunikimit në Gjermani.

Qeveria Federale dhe Shtetet Federale kanë marrë një numër masash për kompletim të kushteve të kornizës ligjore dhe rregullative. Në bazë të analizimit të veprimeve mbi digjitalizimin në Gjermani, të gjitha rregullat e zbatueshme për kalimin nga transmetimi analog në digjital, janë të përfshira në Urdhërin për Alokim të Frekuencave, që ishte i përfshirë në Bundesrat.

Italia: Autoriteti rregullativ Agicom, fillimisht kishte themeluar Komisionin Nacional për DTT, që i mbledhi ofruesit e përmbajtjes së transmetimit, operatorët e multipleksit, industrinë, universitetet , si dhe institutet e fushës për të kontribuar në hartimin e ligjit për kalimin e transmetimit digjital. Rezultati i punës së tyre në katër grupe studimore autoriteti rregullativ e dorëzoi në Parlamenti Italian.

Në vitin 2002, Parlamenti Italian miratoi ligjin që parashikoi kalim komplet nga televizioni analog tokësor në atë digjital.

Roli tjetër me rëndësi i Autoritetit rregullativ, ishte përcaktimi i objektivave për planifikimin e mjedisit i cili do të mbulohej tërësisht me transmetim digjital, dhe në këtë mënyrë, plani i përgaditur nga autoriteti rregullativ ishte përdorur për të ndihmuar në planifikim për ndërprerjen e transmetimit analog, gjithashtu duke planifikuar edhe mundësinë e akolimit për multiplekset shtesë që mund të vinin në dispozicion pas ndërprerjes së transmetimit analog.

Në bazë të analizimit të legjislacionit të autoritetit rregullativ në Itali, AGCOM e ka mandatin për rregullimin e operatorëve multipleks, ku operatorët multipleks obligohen t'u mundësojnë ofertuesve të pavarur të përmbajtjes dhe transmetuesve, një qasje deri në 40% të kapacitetit multipleks.

¹¹ <http://www.digitaluk.co.uk/>

Përmbledhje

Në bazë të analizimit të përvojave të vendeve të paraqitura më lartë, vërehet se rolin kyç për inicimin e procesit të digjitalizimit, krijimin e grupeve punuese për hartimin e bazës ligjore në përgjithësi e ka autoriteti rregullativ. Përmes bazës ligjore, e cila duhet të jetë mirë e definuar, do të definohen edhe rolet e akterëve që do të jenë pjesëmarrës në procesin e digjitalizimit, dhe në këtë mënyrë do të krijohet bazë e mjaftueshme për të krijuar një ambient transmetimi kualitativ dhe krijimi i një konkurrence lokale që përfundimisht do të jetë në pajtueshmëri me standardet evropiane.

Në lidhje me këtë, sipas përvojës në shumicën e shteteve, roli i agjencisë rregullative në procesin e kalimit në digjital është duke u ballafaquar me shumë aktivitete të kualitetit të lartë, me sa i përket kalimit në transmetim digjital. Sa i përket aktivitetit kryesorë rreth hartimit të politikave, agjencioni rregullativ duket të jetë mbështetës ndaj legjilativit në draftim të Akteve relevante nga qeverisja, për ndërprerjen e transmetimit analog. Sa i përket implementimit të politikës, aktiviteti kryesor i autoritetit rregullativ është draftimi dhe kryerja e procedurave të licensimit, pasuar nga alokimi i frekuencave dhe përbërja e multiplekseve. Sic duket nga përvojat e shteteve që tanimë kanë lancuar DTT-në, autoriteti rregullativ duhet të jetë gjithnjë e më shumë i përfshirë në sfidat që dalin nga kalimi në transmetim digjital.

Kompetenca teknike, ekonomike dhe juridike e autoritetit rregullativ do të jetë jetike në disenjimin e kornizës më të përshtatshme rregullative. Gjithashtu, si në skenarin e transmetuesve tokësor, transmetuesit do të bëhen në shumicën e shteteve “operatorë të rrjetit” dhe si të tillë edhe në Kornizën e re evropiane për rrjete elektronike të komunikimit, dituri e re dhe aftësi profesionale do të duhet të fitohen, në mënyrë që të menaxhohet kjo natyrë e dyfishtë e transmetimit, që do të rregullohet në një rën anë si rrjet i komunikimit, dhe në anën tjetër për përmbajtjet audiovizuale.

Kështu, roli i autoritetit rregullativ në zhvillimin e DTT-së sipas funksionit të vet, do të duhej të jetë në qeverisjen dhe koordinimin e ndërprerjes së transmetimit analog duke krijuar politika, aktivitete mbështetëse dhe hartimin e legjislationit relevant. Gjithashtu, rol të rëndësishëm do të ketë edhe në implementimin e politikave dhe në alokim të frekuencave, në përcaktimin e procedurave të licensimit, rregullores për qasje në platformën digjitale, zgjedhjes së operatorëve të rrjetit dhe ndikimit në përmbajtjen e multiplekseve, dhe përfundimisht rol të veçantë do të ketë në zgjidhjen e konflikteve në mes kanaleve dhe të platformave të transmetimit.

Alokimi i frekuencave per Multipleks dhe menaxhim te multipleksit

Në bazë të analizimit të veprimeve në vendet që janë marrë për studim, siç u përmend edhe më lartë, rregullatori ka rol të rëndësishëm edhe në alokimin e multiplekseve dhe në menaxhimin e tyre. Frekuencat për multiplekse janë të alokuara përmes konkurrimit të hapur. Aplikimi duhet të përfshijë karakteristikat e rëndësishme të multipleksit, sic janë frekuencat, zona e mbuluar, kapaciteti i kanalit, standardet teknike që duhet të përmbushen, vëllimi i kapacitetit të rezervuar, etj. Për t'u bërë operator multipleks, një entitet ligjor duhet të marrë aprovim përmes konkurrencës së hapu për përdorim të frekuencave për multipleks, transmetim digjital, televizioni mobil dhe shërbimet tjera inovative.

Në bazë të përvojave në vendet të cilat janë marrë për këtë studim, për përdorim të frekuencave operatori paguan një pagesë, varësisht në llojin e multipleksit. Kufizimet duhet të definohen në lidhje me numrin maksimal të multiplekseve (p.sh. dy ose tri) që do të jenë të disponueshme për operatorin e multipleksit.

Operatori i multipleksit nënshkruan një marrëveshje edhe me dhënësit e pëlqimit dhe me pronarin/menaxherin e infrastrukturës përmes së cilës sinjalet e multipleksit janë të shpërndarë.

Operatori multipleks mund të jetë dhënësi i pëlqimit, por në këtë rast aktiviteti i një operatori duhet të performohet nga kompania ligjërish e pavarur ose për të mbajtur libra të ndarë mbi aktivitetet në lidhje me menaxhimin e multipleksit.

Operatori multipleks duhet të ofrojë kushte të barabarta dhe jo-diskriminuese për të gjithë dhënësit e pëlqimit për të pasur qasje në multipleksin që është nën menaxhimin e tij. Kjo aplikohet edhe kur operatori i multipleksit është gjithashtu dhënësi i pëlqimit. Konkurrenca duhet të definojë pjesën e multipleksit që mund të përdoret për qëllime vetanake dhe pjesa që do të ofrohet për palët tjera të interesuara.

Njoftimi i Publikut për procesin e digjitalizimit

Është e nevojshme ndihma e shtetit për të përshkruar masat që do të inkurajojnë tregtarët dhe qytetarët për të marrë resiverë digjital, për të stimuluar zhvillimin e një industrie për fabrikim të pajisjeve STB dhe për të motivuar operatorët të planifikojnë dhe ndërtojnë rrjetet e transmetimit digjital.

Stimulimet duhet të jipen me kujdes, duke respektuar kushtet për dhënie të ndihmës shtetërore. Stimulimi i marrjes së pajisjeve duhet të jetë teknologjikisht neutral dhe duhet t'u referohet pajisjeve me standarde të hapura për interaktivitet.

Stimulimet për ndërtim të rrjeteve të transmetimit digjital janë të justifikuara vetëm ku mbulimi i sinjalit është relativisht i dobët ose nuk ekziston, dhe në moment nuk ka ofertë reale dhe/ose qendrueshmëri financiare për një iniciativë provate për të ndërtuar në këto lokacione.

ROLI I INDUSTRIË SË TELEKOMUNIKIMIT

Në bazë të analizimit dhe interpretimit të strategjive të vendeve për këtë studim, kemi konstatuar se strategjia për kalim në sistem digjital duhet të jetë proces i koordinuar mirë në kohë dhe në hapësirë, dhe duhet të jetë i pranueshëm për të gjitha palët e përfshira. Gjatë procesit të tranzicionit, paraqitja e sistemeve digjitale të transmetimit do të shkaktojë kosto shtesë për të gjitha palët e përfshira. Megjithatë, ka efekte pozitive afatgjate edhe për përdoruesit final të sistemeve digjitale të transmetimit dhe për të gjitha palët e përfshira në implementim.

Sipas analizimit të strategjisë së Malit të zi për kalimin e transmetimit digjital, vendosja e shpejtë e datës për ndërprerjen e transmetimit analog dhe specifikimi i STB-së dhe pajisjeve tjera, do të mundësojë krijimin e një oferte me kualitet të duhur dhe mbrojtje të konsumatorit (shikuesit), si dhe do të ketë kundërshtim të reduktuar për shkak të imponimit për ndërrim të receptorëve.

Çdo vonesë në vendosje të afatit për ndërprerjen e transmetimit analog, rrit koston për pjesëmarrësit në zingjirin e prodhimit, shpërndarjes dhe në veçanti te konsumi i shërbimeve audio-vizuele në epokën digjitale, sepse fushatat reklamuese për një lloj të caktuar të pajisjeve receptive mund të dekurajojnë shitjen e një lloji tjetër. Të gjitha këto, në vend të dekurajimit, mundën në fakt të inkurajojnë blerjen e pajisjeve analoge dhe në fund, pakënaqësia e konsumatorëve ballafaqohet me blerjen e paevitueshme të receptorit digjital. Kështu, definimi i menjëhershëm i afateve të qarta, do të stimulojë ndryshimin e bazës receptive dhe do të lehtësojë procesin.

Mbështetja financiare

Shpesh, anëtarët e shoqërisë me më së paku të drejta, mbështetën në shërbimet analoge të televizionit, dhe kanë nevojë të informohen për mënyrën e përgatitjes për kalim në digjital. Përsëri, është ky grup që mund të jetë më i vështiri për të arritur nëpër kampanjat tradicionale të informimit.

Shumë shtëpiakë do të kenë nevojë për ndihmë me tranzicionin në digjital. Për disa, asistenca financiare do të jetë e domosdoshme, për të mundësuar blerjen e pajisjeve që mundësojnë marrjen e shërbimeve digjitale. Për të tjerë, asistenca fizike do të jetë e nevojshme për të ndihmuar në montimin e pajisjeve të reja digjitale.

Vendosja se kush duhet të përfitojë nga kjo ndihmë është adresuar nga disa qeveri nacionale.

Sidoqoftë, për shkak se shumë popuj që nuk janë të përshtatshëm për këtë skemë të ndihmave, gjithashtu do të kenë nevojë për asistencë, Digital UK ka punuar së afërmi me shërbime bamirëse lokale, grupe të vullnetarëve dhe konsumatorëve, për t'u ndihmuar atyre në nevojë. Është

financimi i një iniciative, Digital Outreach (Shpërndarje digjitale), që mandaton programet e asistencës për kalim në transmetim digjital, në organizatat bamirëse.

Në Francë, qeveria ka ndarë fonde për projektet për kalim në digjital. Kjo siguron që të gjitha shtëpitë/familjet që janë të shkarkuara nga pagesa e licencës së televizionit, bazuar në moshë ose nivel të të ardhurave, do të marrin mbështetje financiare. Për më tepër, mbështetja është gjithashtu e disponueshme për ato shtëpi që mund të kenë qasje në television vetëm duke përdorur platformën tokësore. Ndihma mund t'u ipet edhe atyre shtëpive që gjenden në rajonë kufitare, nëse ka nevojë për përshpejtim të procesit të ndaljes së shërbimeve analoge.

Në konsiltimet e veta për ndaljen e shërbimeve analoge, rregullatori i transmetimit, (Conseil supérieur de l'audiovisuel CSA), ka pranuar që qeveritë lokale dhe shoqatat do të luajnë një rol kyç në dhënien e asistencës. Megjithatë, dhënia e mbështetjes për entitete kolektive si spitalet, shkollat dhe shtëpive të pleqve, mbetet ende për tu definuar.

Në disa shtete, ndihma financiare është kryer përmes shërbimeve sociale (p.sh. Suedia dhe Gjermania). Në Berlin, përafërsisht 6000 pranues/resiverë janë shpërndarë te familjet me të ardhura të ulta, që janë mbështetur në platformën tokësore për qasje televizive, por që nuk kanë pasur mundësi të blejnë një resiver DTT.

Megjithatë, pasiqë kosto e resiverëve digjitalë ka vazhduar të bie, ato janë bërë më të arritshme për një proporcion më të madh të shtëpive.

Në Mretërinë e Bashkuar, çështja qendrore e analizës së kost-benefitit e kryer nga ekonomistët e DCMS-së dhe DTI-së sygjeron që kompletimi k Kalimit digjital në MB do të rezultojë në beneficione të numërueshme në rajon me rreth £1.1 deri £2.2 miliardë në terme të vlerës së tanishme neto. Kjo tregon që ndalja e transmetimeve analoge tokësore është në interes ekonomik për Mbretërinë e Bashkuar.

Beneficionet kryesore nga Kalimi janë për:

- Shtëpitë/familjet që do të fitojnë opsionin e marrjes së televizorit digjital përmes një aeriele, kur mbulimi i televizionit tokësor digjital është rritur në kalim, për të qenë substancialisht i njejtë si mbulimi i tanishëm analog.
- Konsumatorët dhe prodhuesit që do të vlerësojnë cdo shërbim të ri që është zhvilluar duke përdorur spektrin e liruar.
- Transmetuesit që nuk do të paguajnë më koston e shërbimeve të transmetimit në formë analog dhe digjitale.

Për më tepër, kalimi do të cojë tek ulja e barrierave për hyrje dhe në rritje të konkurrencës në tregun e transmetimit.

Kostot kryesore të kalimit janë për:

- Konsumatorët të cilët nuk kanë konvertuar ende televizorët e tyre ose video-incizuesit në digjital, pasi që ata do të duhet ta bëjnë këtë gjë, në mënyrë që të vazhdojnë të marrin ose të incizojnë transmetime pasi të jenë ndërprerë transmetimet analoge.
- Konsumatorët që mund të paguajnë për një rritje në konsum të energjisë, për shkak të përdorimit të pajisjeve elektronike shtesë për të konvertuar televizorët dhe videot e tyre (edhe pse përmirësimet me kohë në eficiencë të energjisë pretet të rezultojnë në zero rritje në përdorim të energjisë).
- Transmetuesit që do të duhet të konvertojnë sistemin e tyre të tanishëm analog tokësorë në system digjital.

Në Mbretërinë e Bashkuar, Skema e Ndhmës për Kalim në Digjital, me një buxhet prej £600 milion është vendosur për të mbështetur rreth 7 milion shtëpi. Mbështetja e tillë përfshin pajisje për të konvertuar një set televiziv, ndihmon me instalim dhe bën një zëvendësim ajror nëse mendohet të jetë e nevojshme. Shtëpitë me së paku një anëtar që është 75 vjeçar ose më i vjetër ose që ka aftësi të kufizuara, janë gjithashtu të përshtatshëm për këtë program.

Në vitin 2006, Qeveria italiane miratoi një vendim, në të cilin alokoi 110 milion euro nga buxheti i qeverisë për t'u ndihmuar familjeve të blejnë STB përderisa reduktohet niveli i subvencionimit individual nga niveli i atëhershëm prej 70 në 50 euro.

Brenda kornizës së legjislacionit evropian, Republika e Sllovenisë do të inkurajojë pjesëmarrjen e industrisë së brendshme dhe teknologjisë në kalim të transmetimi digjital, pasi që ka një numër kompanishë në Slloveni, që do të mund të ipnin teknologji për transmission dhe pajisje marrëse të DTT-së.

Në bazë të Programit për Zhvillim Nacional për 2007-2013, Republika e Sllovenisë ka gjasa të alokojë një buxhet të caktuar për të inkurajuar akterët pjesëmarrës në kalim në transmetim digjital, në pajtueshmëri me ligjin evropian. Ky financim do të pëdorej për të bashkë-financuar resiverët për sinjale digjitale (STB-të), në mënyrë që të mundësohet marrje e përshtatshme e programeve me sete analoge televizive; një pjesë e financimit parashihet të alokohet për informim dhe inkurajim të përdoruesve për të kaluar sa më shpejt të jetë e mundur, dhe për mbulim dhe ndërtim të rrjeteve në rajone më pak të populluara dhe më të izoluara, në të cilat investitorët komercial nuk do të shihnin justifikim komercial. Qëllimi i promovimit të kalimit, është të përmirësohet marrja e programeve, shërbimet shtesë dhe shërbime të përmirësuara dhe promovim të shpërndarjes së informative në publik.

PROCESI I KALIMIT NË TRANSMETIM DIGJITAL – PËRVOJA NË SHTETE TJERA

Resurset e nevojshme për kalim: njerëzore dhe materiale – publike dhe private

Parlamenti dhe Qeveria: janë përgjegjës për miratimin me kohë të kornizës së duhur legislative, nëse është e nevojshme, edhe skemën financiare për subvencionim. Është në veçanti me rëndësi që të vendoset data për ndaljen e transmetimit analog. ASO¹² mund të kontribuojë në rritjen e të ardhurave publike nëse spektri i frekuencave lëshohet dhe përmes menaxhimit të dividentit digjital të mirret vendimi për shitjen e tyre. Prap se prap, duhet të merret parasysh që ndalja e analogut mund të ketë ndikim të madh negativ në rast të dështimit. Nëse nuk menaxhohet mirë, pa identifikim me kohë të kufizimeve të patejkalueshme për arritje të afateve, ky proces do të rezultonte në parandalim që qytetarët të marrim sinjal të radios dhe televizionit bazuar në qasje të lirë, dhe kështu ka qenë deri tani. Do të ishte tejet negative për ngasësit e procesit dhe do të vështirësonte pozitën e tyre, pasi që mund të shkaktojë kundërshtim brenda disa segmenteve të shoqërisë drejt procesit si tërësi.

Ministria për kulturë, Rini dhe Sport; Ministria për Ekonomi dhe Financa; Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale; Ministria për Arsimit Shkencë dhe Teknologji: pas miratimit të kornizave relevante rregullative, këto ministri do të ishin përgjegjëse për mbështetje të plotë të procesit me masa dhe politika të përbashkëta. Kjo reflektohet në planifikim me kohë, financim dhe promovim të masave për të stimuluar:

- Prodhimin e përmbajtjeve të ndryshme audio-vizuele, në veçanti ato të dedikuara për target grupe të veçanta që mund të llogariten me përmbajtje të reja, tani për tani të padisponueshme, e që do të vijnë në dispozicion përmes digjitalizimit;
- Aktivitetet me qëllim ngritjen e diturisë rreth mediave;
- Eliminimin ose heqjen e barrierave të bizneseve, për kompani brenda zingjirit për prodhim, transmetim dhe shpërndarje të programeve të radios dhe televizionit, si dhe të gjitha shërbimet tjera audio-vizuele.

Autoritetet rregullative për transmetim dhe telekomunikacion: Brenda kompetencave të tyre dhe ushtrimit të bashkëpunimit të dyanshëm, ata duhet të definojnë dhe të kryejnë alokimin e frekuencave në mënyrë transparente, efikase dhe me kohë. Kontributi i tyre qenësor do të jetë promovimi i procesit dhe sigurimi i një forumi të gjerë për të shkëmbyer opinione, njohje të problemeve dhe zgjidhje të mundshme.

¹² Analogue Switch Over (ndërpretja e transmetimit analog)

Duke filluar nga resurset humane dhe teknike për kryerje të procesit, organet rregullative gjithashtu do të luajnë rol të rëndësishëm në vlerësimin kualitativ dhe në kohë të procesit. Njohja e sasisë së kohës në dispozicion (deri në fund të vitit 2012) brenda së cilës të gjitha fazat e rëndësishme duhet të implementohen para ndaljes së transmetimit analog, autoritetet kompetente shtetërore dhe organet rregullative duhet të sigurojnë kordinim maksimal të aktiviteteve të tyre, për të qenë në gjendje të arrijnë afatet.

Institucionet arsimore (akademia, shkollat fillore dhe të mesme): me trajnimet e rregullta, specialiste dhe të tjera si dhe me kurrikulum, këto institucione kontribuojnë në përshpejtim të procesit dhe e çojnë atë në një përmbyllje të sukseshshme. Në një anë, ato kanë nevojë të ofrojnë programe për t'iu përgjigjur nevojës për kualifikime të reja në tregun e punës, të specializuar për futjen në procesin e prodhimit, promovimit, shitjes dhe shpërndarjes së programeve të radios dhe TV-së, p.sh. të gjitha shërbimet audiovizuale dhe sistemet ndihmëse.

Transmetuesit (komercial dhe publik): janë ndër akterët më të rëndësishëm që në esencë përcaktojnë suksesin e procesit nga korniza kohore për përfshirjen e tyre. Ata do të duhet të jenë të parët që fillojnë procesin, duke qënë në një anë ofertues të shërbimeve të reja me kualitet më të mirë, dhe në anën tjetër, përdorues të rëndësishëm të shpërndarjes së re digjitale dhe të sistemeve të transmetimit. Nëse këto dy anë të operimit të tyre nuk koincidojnë, transmetuesit do të ballafaqohen me sfida të mëdha për shkak të investimeve substanciale të cilave u ekspozohen, nëse nuk janë në gjendje të ofrojnë kthimin e tyre me kohë.

Përmirësimi i ofertës së tyre për shërbime e përmbajtje të tanishme dhe të reja do të ketë ndikim mbizotërues në besimin dhe mbështetjen për procesin. Nëse oferta më të mira nuk ofrohen, procesi mund të ballafaqohet me kundërshtim nga ata që nuk shohin interes në kalim të teknologjia e re, që u shkakton atyre shpenzime të jashtëzakonshme. Kjo gjithashtu do të ngriste çështjen e mbijetesës së atyre transmetuesve që dështojnë të njohin të gjitha avantazhet e digjitalizimit dhe nuk involvohen në process me kohë.

Është shumë me rëndësi që qëndrimi dhe roli i luajtur nga transmetuesit ekzistues tokësor, dhe në vecanti Transmetuesi Publik, mund të ketë ndikim të fuqishëm në marrjen e platformave të DTT-së.

Duhet të mirren parasysht:

- Resurset financiare të transmetuesit dhe investimet në DTT,
- Aktivitetet digjitale, zhvillimi i kanaleve dhe shërbimeve tjera për platform digjitale,
- Obligimet e vendosura me ligj për transmetuesit tokësor në zhvillim të DTT-së.

Treguesit e sipër-përmendur do të ndihmojnë në vlerësim nëse dhe në cilat shtete është luajtur rol udhëheqës nga transmetuesit tokësor, duke iu falenderuar kornizës rregullative dhe veprimeve politike në një anë, dhe iniciativës dhe mundësisë së vetë transmetuesve në anën tjetër.

Shoqatat e konsumatorëve dhe transmetuesve: ata duhet të japin kontribut të rëndësishëm në edukim, ngritje të vetëdijes dhe promovim të digjitalizimit. Ata pritet të mbrojnë interesat e target grupeve të cilat i përfaqësojnë në mënyrë profesionale dhe të përgjegjshme, por gjithashtu të kontribuojnë me konstruktivitet, në implementimin e procesit në tërësi. Ata mund të kenë kontribut qenësor në vlerësimin dhe ngritjen e vetësisjes me kohë, për problemet e mundshme dhe zgjidhjen e tyre.

Përdoruesit e fundit: të gjitha avantazhet e njohura të digjitalit krahasuar me transmetuesin analog, do të stimulojnë shitjen e IDTV dhe STB për marrje digjitale vetëm nëse promovohet më qartë dhe më fuqishëm. Duhet të mbahet në mend që një faktor i rëndësishëm në vendosjen për të ndryshuar receptorin do të jenë standardet e tanishme të jetesës së shtëpiakëve. Kështu, pa subvencione të caktuara, një pjesë e shtëpiakëve do të ballafaqohem me pamundësinë për të mbuluar kostot e kalimit nga receptorët analog në ata digjital.

Në rast kur kalimi nga sistemet analoge të transmetimit në digjital dështon të ofrojë mbulesë të mirë, disa shtëpiakë do të ballafaqoheshin më kosto tjera të tranzicionit në sisteme tjera të shpërndarjes për sinjale të radios/TV-së (satelitor, kabllor etj).

Duhet të merret parasysh që një stimul i rëndësishëm në arritjen të vendimi për ndërrim të receptorit është perceptimi i mundësisë së përdorimit të shërbimeve të reja ose më të mira. Besimi që pajisjet e reja nuk do të çojnë në ofertë të përmirësuar për përmbajtjet dhe shërbimet, mund të shkaktojë pakënaqësi duke imponuar nevojën për transfer të teknologjitë e reja.

PËRFUNDIM

Digjitalizimi i televizionit tokësor në Evropë implementohet me mbështetje të fuqishme nga DIGITAG¹³, një organizatë e cila inkurajon dhe menaxhon prezantimin dhe implementimin e shërbimeve DTT duke përdorur standardet që janë zhvilluar nga DVB (digjital video broadcasting / video transmetimi digjital), organ me degë nacionale. Në bazë të analizimit të përgaditjes së procesit të digjitalizimit në vendet tjera, themelimi i një dege të tillë në Republikën e Kosovës do të ishte në interes të të gjitha palëve që do të jenë të përfshirë në DTT. Një organizatë e tillë p.sh. do të unifikojë dhe mbrojtë interesat e prodhuesve të pajisjeve, operatorëve dhe përdoruesve të DTT-së. Për këtë qëllim, është e nevojshme të themelohet Organi Kombëtar për Koordinim të Digjitalizimit, duke involvuar të gjithë akterët relevant (KPM, AMPEK, ART, RTK, ekspertët e pavarur, organizatën për mbrojtje të konsumatorëve dhe ministritë relevante) si mbrojtje e institucioneve shtetërore në procesin e digjitalizimit. Puna e këtij Organi Kombëtar për Koordinim do të ishte jo-përfutuese dhe aktivitetet do të financoheshin nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Për qëllime të shtetit, ba zuar në një koncensus të gjerë, Organi Nacional për Koordinim do të draftonte një agjendë, përfshirë afatet kohore, në përcjellje të rekomandimeve të cekura në Strategji, për paraqitjen e shërbimit të ri DTT dhe për mbylljen e shërbimit ekzistues analog.

¹³ www.digitag.org

Organi Kombëtar për Koordinim duhet të ketë përgjegjësi speciale në certifikim të pajisjeve që duhet të instalohen në rrjetet e reja digjitale. Do të jetë me rëndësi të definohen standardet për pajisjet, në mënyrë që operatorët të mund të prokurojnë pajisjet e duhura.

Një standard i pranuar gjerësisht është DVB që definojnë softëerin për përmirësim të p.sh., korrektimin e pajisjeve marrëse. Ky aktivitet realizohet përmes sinjalit transmetues, paralelisht me shërbimin e programit, p.sh., kërkon përdorimin e një pjese të caktuar të spektrit. Detyra e shtetit, p.sh., autoritetit rregullativ, është të definojë pjesën e spektrit për këtë lloj shërbimi.

Për promovim masiv të shërbimit DTT, është e nevojshme të pregatiten klipe promovuese televizive, për të zhvilluar një ueb-site me informata të fundit, për të publikuar materiale promovuese dhe artikuj të duhur, në gazetatat që shiten më së shumti dhe për të promovuar sistemin DTT në kryeqendër, por edhe në qytete tjera më të mëdha në vend, duke instaluar sete televizive në vende publike duke paraqitur multipleksin në sistemin DTT, me programe të pregatitura në vecanti për promovim, p.sh., duke marrë përsipër përkohësisht programe tjera, të pregatitura dhe të transmetuara në të ashtuquajturin format HD¹⁴.

Elemente tjera me ndikim në paraqitjen e DTT

Për përshpejtim të procedurës për paraqitjen e DTT-së, janë të nevojshme edhe disa stimulime tjera (varësisht se si mund të përshkruhen me ligj). Gjatë fazës simuluese, entitetet që japin të dy shërbimet (analog dhe digjital), në bazë të përvojave në vendet tjera që janë analizuar për këtë studim, del se ata duhet të përjashtohen nga pagesa e një prej faturave, dhe do të ishte e dëshirueshme që shumica e pagesës të definohet sipas pjesës së përdorur të spektrit, e jo sipas rrjedhës së instaluar. Komisioni Evropian, përmes projekteve të dedikuara për këtë lloj mbështetjeje mund të asistojë në planifikim të rrjeteve të reja digjitale, duke dhënë pako me softuer të sofistikuar.

Me siguri do të jetë e nevojshme të aprovohen fonde shtetërore për prokurim të disa pajisjeve STB¹⁵, për interesin e konsumatorëve (shikuesve) që do të paguhet p.sh. në pagesa 24 muajshe. Në Maqedoni planifikohet të krijohet një Organi Kombëtar për Koordinim i cili fillimisht të propozojë dinamikën dhe vëllimin e blerjes. Gjatë fazës inicuese të shërbimit analog dhe digjital, pajisjet e reja digjitale duhet të ekzistojnë dhe të funksionojnë bashkë me ato analoge ekzistuese.

Do të ketë nevojë për ndërtim të reja në disa lokacione, kështuqë do të ketë nevojë për pregatitje të rregullimit të lëshimit të lejeve të ndërtimit për pajisje të telekomunikacionit në pronën publike, në procedura të përshpejtuara. Prezantimi i përbashkët i të gjithë operatorëve mund të jap mundësi për interpretim dhe cmime të favorshme për pajisje të STB-së.

¹⁴ High Definition (transmetim i sinjalit me kualitet të lartë)

¹⁵ Setup Box (pajisje për pranimin e sinjalit digjital)

Kompatibiliteti i pajisjeve që do të ipen nga disa operatorë duhet të kontrollohen dhe aprovohen nga Organi Kombëtar për Koordinim. Në procesin e licensimit, avantazh duhet t'u ipet kompanive që do të themelojnë firma vendore në Republikën e Kosovës, në mënyrë që sistemet teknike të mund të jenë të përshtatshme me kërkesat e përdoruesve vendorë.

Hartimi i strategjisë për kalim të transmetimit digjital

Sipas përvojave në procesin e kalimit, nga shtete të ndryshme në këtë studim, tranzicioni nga transmetimi analog në transmetim digjital është proces i gjatë dhe kompleks, me komplikime politike, ligjore, sociale dhe ekonomike, që shkon tutje asaj cka është tranzicion teknik. Transmetimi digjital në një kontekst është pozitiv sepse përmirëson kualitetin e shërbimit të ofruar, si dhe krijon mundësinë për rritje të numrit të kanaleve programuese. Por në anën tjetër, transmetimi digjital prek shumë palë dhe akterë të industrisë së mediave, në vecanti të transmetuesit të radios dhe TV-së, prodhuesit e pajisjeve, konsumatorët, autoritetet rregullative si dhe pjesë special të Qeverisë shtetërore. Ndërsa, përfshirja e këtyre akterëve është një rekomandim nga institucionet ndërkombëtare si Komisioni Evropian, Këshilli Evropian, Parlamenti Evropian, etj ¹⁶.

Procesi i reformimit të fushës audio-vizuele domosdoshmërisht kërkon pajtueshmëri të plotë me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, përfshirë të gjitha modalitetet e tranzicionit nga transmetimi analog në digjital. Për t'u konfrontuar me sfidën e digjitalizimit dhe për të përdorur këtë zhvillim të ri teknologjik, është shumë e nevojshme të zhvillohet një strategji me qëllim për të ecur përpara me procesin e Kalimit në kohë dhe në mënyrë sa më efektive dhe të arrihet afatet kohore.

Strategjia duhet të zhvillohet sipas analizave dhe praktikave më të mira evropiane, por gjithashtu është shumë me rëndësi që të mirret nëkonsideratë situatë e transmetimit në Republikën e Kosovës, aspektet financiare dhe teknike, efektet dhe ndikimet në shoqërinë kosovare për një tranzicion të suksesshëm të këtij procesi.

Për shkak të vonesave në zgjidhjen e proceseve të ndryshme politike, Republika e Kosovës mbetet mbrapa me këtë çështje dhe ende nuk ka filluar të punojë në zhvillimin e këtij procesi. Problemi kryesor pse Republika e Kosovës ka mbetur mbrapa në lidhje me procesin e digjitalizimit, është për shkak të statusit politik të pazgjidhur, dhe kjo ka rezultuar që përfaqësuesit e Republikës së Kosovës nuk kanë mundur të marrin pjesë në konferencën e GE 2006, ku janë kordinuar ndarjet e frekuencave.

Konferenca që është mbajtur në Gjenevë në vitin 2006 (GE-06) ka qenë e rëndësisë së veçantë në lidhje me koordinimin e spektrit të frekuencave, ku janë ndarë frekuencat për transmetim digjital në territorin e Evropës, përfshirë Republikën e Kosovës. Në mungesë të përfaqësuesve të Kosovës, përfaqësuesit e Serbisë kanë vendosur në lidhje me ndarjen e frekuencave, për

¹⁶ Shih Komunikimin për tranzicionin nga transmetimi analog në numeric (COM(2003) 541 final) të Komisionit Evropian.

territorin e Republikës së Kosovës dhe sipas atij koordinimi, nuk mund të mbulohet i tërë territori i Kosovës me sinjal digjital.

Sidoqoftë, Republika e Kosovës, me iniciativë të Komisionit të Pavarur të Mediave, do të fillojë draftimin e një strategjie për procesin e Kalimit, duke vepruar sa më shumë të jetë e mundur, në pajtueshmëri me planin ITU dhe në kordinim me shtetet fqinje, me qëllim të përmbushjes së nevojave për mbulesë të të gjithë territorit të Republikës së Kosovës me sinjal televiziv digjital. Njëkohësisht, Republika e Kosovës duhet të fillojë procesin e aplikimit për të qenë anëtare e ITU-së.

Rekomandimet:

- Të përcaktohen hapat për procesin e kalimit (hartimi i infrastrukturës ligjore, ligji, rregulloret, hartimi i strategjisë dhe përcaktimi i fazave për fillimin e kalimit të transmetimit digjital dhe ndërprerjen e transmetimit analog.
- Qeveria dhe organet rregullative në Republikën e Kosovës duhet të përfshihen gjerësisht në paraqitjen e teknologjive të reja mediatike në Republikën e Kosovës.
- Bazuar në analizën e ndryshimeve të thella në teknologjitë e reja mediale, treg, në sjelljet e audiencës, si dhe në analizën e specifikave locale, Qeveria dhe organet rregullative duhet të zhvillojnë një politikë të sigurtë për konvergencë të sektorit medial në përgjithësi, dhe për shërbimin publik mediatik në vecanti, në mjedis të shumë kanaleve dhe shumë platformave të epokës së digjitalizimit.
- Për politikë-bërje efektive, një shkallë e interesit dhe një sjellje proaktive nga të gjithë akterët është e nevojshme dhe asnjë nga ta nuk duhet të përjashtohet nga proceset kyçe vendim-marrëse, për të arritur konsensus politik, ekonomik, public dhe privat.
- KPM dhe Ministria e Telekomunikacionit dhe Transportit, duhet urgjentisht të zhvillojnë strategjinë për paraqitjen e televizionit digjital në Republikën e Kosovës (duke i kushtuar vëmendje të veçantë periudhës së tranzicionit) dhe duhet të draftohet në kordinim në mes të gjithë akterëve madhir në fushën e mediave dhe komunikimit.
- Autoritetet (KPM, ART) duhet qartë t'i specifikojnë rolet, mënyrat e pjesëmarrjes dhe obligimet për të gjithë akterët e përfshirë në procesin e digjitalizimit.
- Një plan aktivitetesh për tranzicion nga transmetimi analog në atë digjital, duhet të harmonizohet me afatet kohore të Bashkimit Evropian.
- Politikat e standardizimit për digjitalizim duhet të sjellin harmonizim në zgjidhje teknologjike.

FJALOR NË TERMINOLOGJINË E DIGJITALIZIMIT

Alokimi (term i përdorur në planifikim të rrjeteve për transmetim digjital)

Ndarja (term i përdorur në planifikim të rrjeteve për transmetim digjital)

Televizion analog tokësor (operon në frekuenca VHF 174–230

MHz dhe UHF 470–860 MHz, video dhe audio transmetohen në formë analoge në frekuencat e njejtë, secili stacion kërkon kanal të ndarë të frekuencave. Për të mbuluar një zonë të madhe, nevojiten disa kanale të ndryshme të frekuencave, efikasiteti i përdorimit të spektrit të frekuencave është i ulët, interference në transmission dhe marrje është e lartë, formatet standard që përdoren janë sistemet SD dhe PAL)

Caktimi (term i përdorur në planifikim të rrjeteve për transmetim digjital)

COM (2003) 541-F (Dokument i Komisionit Evropian, Komision

Komunikimi në Këshill, Parlamenti Evropian, Komisioni Ekonomik dhe Social dhe Komisioni i Rajoneve për tranzicion nga transmetimi analog në digjital)

COM (2005) 204-F (Dokument i Komisionit Evropian, Komision

Komunikimi në Këshill, Parlamenti Evropian, Komisioni Ekonomik dhe Social dhe Komisioni i Rajoneve për përshejtim të kalimit në transmetim digjital)

DAB – Transmetimi digjital i audios (gjithashtu i quajtur T-DAB, DAB-tokësor, Përmirësimi i sistemit të tanishëm FM, transmetim standard digjital I sinjaleve audio, zhvilluar në Bashkimin Evropian në mes 1997 dhe 2000, operon në 30 MHz-3 GHz e destinuar për të gjitha llojet, tokësor, satelitor dhe kabllor, përdor metodën MUSICAM – MP2 për kodim, transmetim 32–256 kbit/s, modulim COFDM–, për transmetim përdor kanalën 12 në VHF dhe L– spectrum, 1452–1492 MHz)

Vlera e shtuar digjitale (shërbime të reja të mundësuar nga transmetimi digjital)

Televizioni digjital tokësor (DTT, sistemi DVB-T ose DVB-H, metoda të transmetimit digjital, ku sinjalet bazike të audios dhe videos janë të konvertuara, rregulluara dhe të koduara në një format digjital dhe të përhapura si të tilla; kompresimi mundëson një kanal të frekuencave me gjerrësi 8 MHz – VHF dhe 7 MHz – UHF – për të kryer tri deri në pesë programe të ndryshme, metoda digjitale ka një përfitim transmetimi prej 10 dB krahasuar me atë analog, për shkak të ndjeshmërisë më të madhe të resiverëve digjital dhe procedurave të marrjes së sinjalit (modulimi, raporti i kodimit, ruajtja e intervaleve, kodimi), mundëson marrje mobile; Marrja kërkon një kulm, Brenda apo jashtë, mbulimi i një zone më të madhe ka nevojë për një rrjet që mund të operojë si Single Frequency Network SFN (rrjet i vetëm i frekuencave) ose Multi Frequency

Netëork MFN (Rrjet të shumëfishtë të frekuencave; e fundit është më efikase por është më e vështirë për t'u planifikuar dhe implementuar)

DMB – Digital Multimedia Broadcasting (Trasmetimi digjital multimedial) (përmirësim i sistemit standard digjital të transmetimit audio, që ka për qëllim të transmetojë stacione dhe të dhëna televizive dhe në radio, operon në bazë tokësore, satelitore dhe mobile, përdor metoda ekzistuese dhe shtesë për procesim të sinjalit që mundësojnë transmetim deri në 1.5 Mbit/s ose 4-5 stacione të ndryshme televizive, operon në 30 MHz-3 GHz, për transmetim përdor VHF 174–230 MHz dhe L-spectrum, 1452–1492 MHz)

DVB-C – Digital Video Broadcasting – Cable (Trasmetimi digjital i videos – kabllor) (sistem i transmetimit të videos, i bazuar në kabllor, që përdor kodim MPEG-2 dhe modulim QAM 64, 128, 256, gjithashtu mundëson një lidhje duplekse – interaktivitet – dhe kështu përdoret për shërbime të internetit, VOD – video sipas kërkesës, PPV – paguaj për të parë, operon në bazë MHP)

DVB-H – Digital Video Broadcasting – Handhelds (Trasmetimi digjital i videos- pajisjet e dorës) (Metodë tokësore e transmetimit të videos digjitale për pajisje të vogla të lëvizshme (mobile) që mbahen me dorë, gjithashtu e quajtur marrje mobile, transmetimi i të dhënave mund të operojë mbi rrjetin e njejtë si DVB-T, në mënyrë simultane në kanalin e njejtë, por një përdorim i tillë ka më pak gjasa të ndodhë, pasi që sistemet e procesimit dhe metodat e transmetimit janë ë ndryshme, përdor sistemin e kodimit MPEG-4, mekanizmin e ndarjes së kohës bazuar në transmetim të të dhënave IP, që nënkupton që transmetimi i të dhënave ndodh në ndarje kohore dhe jo në vazhdimësi, si kërkohet nga përdorimi i limituar i pajisjeve mobile, për shkak të energjisë, kapacitetit të baterive; përdor transformimin IFFT të bartësve 2K, 4K ose 8K, modulim COFDM dhe mbrojtje shtesë e kodimit MPE-FEC, kapaciteti i transmetimit në një kanal individual, varet nga parametrat e zgjedhura, që variojnë nga 5-25 Mbit/s)

DVB-S – Digital Video Broadcasting – Satellite (Trasmetimi digjital i videos – satelit) (metoda më së shpeshti e përdorur për transmetim digjital, në disa satelite: Astra, Eutelsat, Helasat, përdorin sistemin e kodimit MPEG-2 dhe modulimin QPSK, që mundësin kapacitet shumë të lartë të transmetimit, pasi që për shkak të resiverëve aktiv dhe kontrollues në ajër - Konvertuesi bllokues me zë të ulët (Loë Noise Block Converter, LNB)– ne mund të marrim sinjale në katër nivele të ndryshme, dy frekuenca dhe dy nivele të polarizimit)

DVB-S2 – Digital Video Broadcasting – Satellite (Trasmetimi digjital i videos – satelit) (përmirësimi i transmetimit bazik satelitor i sinjaleve digjitale, me 30% më shumë efikasitet të transmetimit, për shkak të modulimit dhe sistemeve të përmirësuar të kodimit)

DVB-T – Digital Video Broadcasting – Terrestrial (Trasmetimi digjital i videos – tokësor) (gjithashtu i quajtur DTT, standard i definuar në Evropë dhe tjetërkund, për television digjital dhe transmetime audio, që mund të mirren në ajrore, transmetimi i të dhënave për secilën operon në sistemin e kodimit MPEG-2, përdor gjerësinë e njejtë të kanalit si transmetimi analog VHF dhe UHF, 7 MHz, por gjerësia e njejtë e kanalit mund të bartë më shumë programe të ndryshme

për shkak të procedurave të modulimit COFDM, 16-QAM ose 64-QAM, kapaciteti i transmisionit në një kanal individual, varet nga parametrat e zgjedhura dhe është në shkallët 12-20 Mbit/s, programet individuale në kanal kërkojnë kapacitet prej 3-5 Mbit/s, menaxhuar nga një multipleks dinamik)

DVI – Digital Visual Interface (ekspozimi digjital vizuel) (ekspozimi digjital për transmetim vetëm të sinjaleve puro digjitale të videos, pa konvertim)

eEurope 2005 (Plani i veprimit për zhvillim të shoqërisë informative në Evropë – eEurope 2005 – është miratuar në qershor 2002 në Sevilla, me qëllim të zhvillimit të biznesit elektronik, e-mësimi, e-shëndetësisë, dhe e-administratës, në bazë të lidhjeve të sigurt të frekuencave; në Pikën 3.1.4 të Planit të Veprimit në lidhje me masën për përdorim të lidhjeve të broadband, masat janë të listuara për spektrin e radiofrekuencave, përdorimi lidhjeve broadband në rajone më pak të populluara eliminimi i barrierave për përdorim më të gjerë të broadbandit, përmbajtjet në platform të ndryshme dhe kalimi në transmetim digjital; parasheh një vlerësim të situatës në tregje të rëndësishme në shtetet anëtare, dhe miratimin e planeve nacionale të implementimit për kalimin në transmetim digjital, plani i veprimit eEurope 2005 përfundon në fund të vitit 2005, për t'u zëvendësuar me kornizën strategjike i2010)

Dividenti i frekuencave (gjithashtu i quajtur dividendi i spektrit, frekuencat ose spektri që do të lëshohen pas kalimit nga transmetimi analog në atë digjital, për shkak të 3-6 palë rritjesh në efikasitetin në përdorim të spektrit, dhe kompresionit të të dhënave digjitale. Një term i paraqitur nga Komisioni Evropian gjatë paraqitjes së qasjes së tregut, për diskutim të spektrit të rekuencave. Termi dividend digjital përdoret gjithashtu ndonjëherë).

Spektri i frekuencave (vargu i frekuencave të valëve elektromagnetike nga 0-3000 GHz, ndarje e përafërt në disa vargje, ultra- të ulta, shumë të ulta dhe radio 30 KHz 300 GHz)

HDMI – High Definition Multimedia Interface (ekspozim multimedial me definicion të lartë) - (ekspozim, pajisjet më të fundit standard për transmetim të sinjaleve video dhe audio HDTV deri në 5 Gbit/s, nga 1 korrik 2005, gjithashtu mundëson HDCP – High-bandwidth Digital Content Protection – Mbrojtje të lartë të përmbajtjes digjitale në gjerësinë e valëve)

i2010 (Iniciativa 2010, një dokument i lëshuar nga BE me 1 qershor 2005, në lidhje me shoqërinë informative, që promovon rritje dhe punësim; ka për qëllim një zonë të vetme evropiane për informim, me komunikime të sigurt dhe të arritshme, përmbajtje të pasur dhe të ndryshme dhe shërbime digjitale)

ITU – International Telecommunications Union (Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit)-(organizata ndërkombëtare për telekomunikacion, anëtare e Kombëve të Bashkuara, qeveritë nacionale dhe individ privat koordinojnë rrjetet dhe shërbimet globale të telekomunikacionit; përgjegjëse për stanradrizimin, harmonizimin dhe zhvillimin, përfshirë rregullimin e përdorimit të spektrit të transmetimit dhe koordinimin e politikave nacionale)

MHP – Multimedia Home Platform (Platforma Multimediale Shtëpiake) (e definuar ndërkombëtarisht si standard për transmetim dhe playback të përmbajtjes interactive në television digjital, bazuar në gjuhën programuese JAVA)

MP – Multiplex (shih Multiplex)

MP(E)V-A (Multiplex për ndarje, MPE(V) – përcakton për cilën njësi,

MPEG-2 (standard i përgjithshëm për video, për kodim të audios dhe videos me kompresion; në fakt, nuk është kompresion por kufizim i të dhënave; është paraqitur në vitin 1994 si pauses i MPEG-1. Është i definuar si standard bazik për DVB, mundëson transmetimin e të dhënave deri në 50 Mbit/s)

MPEG-4 (standard i përgjithshëm për video, për kodim të audios dhe videos, pasues i standardit MPEG-2 nga viti 1998, që ka përqëllim sistemet me kapacitet të ultë dhe gjerësi të valëve, si telefonat mobil dhe telefonat video, por me zhvillim të algoritmeve të kompresionit më kompleks dhe kufizimeve në të dhëna, ata dëshirojnë ta përdorin atë në të ardhmën për DVB, për të rritur kapacitetin e transmetimit)

MULTIPLEX – Multiplex, MP (pjesë e sistemit digjital të transmetimit në telekomunikacion, që kombinon shumë kanale të futura, programe. Dhe pastaj i transmeton ato në një system të përbashkët të transmetimit; në terminologji DVB, kjo i referohet të gjithë sistemit që operon në një kanal të vetëm të frekuencave në një rrjet SFN ose MFN dhe që ofron katër ose më shumë programe të ndryshme)

MULTIPLEX – Multiplex, MUX (pajisje, pjesë e sistemit digjital të transmetimit në telekomunikacion, kombinon disa kanale të ndryshme e programe, para – me kontrollë të caktuar nga jashtë – transmetimit të tyre në një system të përbashkët transmetimi; në teknologjinë DVB të ashtuquajturat multiplekse dinamike përdoren, të cilat automatikisht përshtasin shkallën dhe kapacitetin e programeve individuale në kanal si tërësi)

RRC-06 – Regional Radiocommunications Conference (Konferenca rajonale për Radiokomunikim) - (konferenca rajonale për radio, për Rajonin 1, Evropë dhe Afrikë, që do të mbahet në Gjenevë, Zvicërr, në Prill/Maj 2006 dhe organizuar nga ITU, që përfshin përgatitjen për dhe marrëveshjen në bazë teknike për planifikim të radios dhe televizionit digjital për transmetim tokësor për valë të frekuencave VHF, 174 – 230MHz dhe UHF, 470 – 862 MHz)

SDTV – Standard Definition Television (përdorur nga sistemet analoge të transmetimit, formatet standard janë PAL, 720 kolona x 576 radhë, 50 korniza në second, dhe NTSC, 720 kolona x 480 radhë, 60 korniza në second, dhe dy metoda “progresive”, transmetimi pamjeve tërësore, dhe “të gërshetuara”, transmetimi i pamjeve të pjeshshme) **simulcast** (transmetim dual i sinjalit televiziv tokësor duke përdorur teknika digjitale dhe analoge)

Strategjia e Lisbonës (dokument i lëshuar nga Komisioni Evropian në vitin 2000, në samitin e Ministrave në Lisbonë, Portugali; definon strategjinë për shndërrimin e Evropës në ekonominë më konkurruese dhe dinamike, të bazuar në dituro, me punësim të rritur dhe politikë me kohezion social, deri në vitin 2010.

REFERECAT:

Shqipëria:

<http://www.kkrt.gov.al>

<http://www.kkrt.gov.al/images/stories/strategjia%20e%20redaktuar.pdf>

http://www.kkrt.gov.al/index.php?option=com_content&task=view&id=92&Itemid=43

Slovenia:

<http://www.apek.si>

<http://dvb-t.apek.si>

Serbia:

http://www.mediacenter.org.yu/upload/documents/istrazivanje/Serbia_PBS_and_Digital_Age.pdf

<http://www.anem.org.yu/admin/article/download/files/Digitalisation%20of%20the%20Broadcasting%20Sector%20-%20Recommendations%20for%20Media%20Policy.pdf?id=108>

Suedia:

<http://www.regeringen.se/content/1/c6/05/53/95/0b6e87ed.pdf>

<http://www.regeringen.se/content/1/c6/11/30/58/5153a9e7.pdf>

Mbretëria e Bashkuar:

<http://www.ofcom.org.uk>

<http://www.ofcom.org.uk/radiocomms/ddr/>

<http://www.ofcom.org.uk/consumeradvice/tv/digital/>

<http://www.digitaluk.co.uk/home>

Maqedonia:

Saso Bogdanovski (kontakt personi pwrmes telefonit)

proekti@srd.org.mk

<http://www.srd.org.mk>

Mali i Zi:

<http://www.ard.cg.yu>

http://www.ardcg.org/index.php?option=com_docman&task=cat_view&gid=27&Itemid=26

Bosna Hercegovina:

Amela Odobasic (kontakt personi)

www.dtt.ba

http://www.dtt.ba/eng/Bilten_eng/DTT%20Forum%20Bilten_br10_eng.pdf

<http://www.rak.ba>;

Kroacia:

<http://www.e-mediji.hr/>;

http://www.dvb.org/about_dvb/dvb_worldwide/croatia/index.xml

http://www.digitalni-dividenda.cz/file/en/080925_switchover-and-digital-dividend-Croatia.pdf

Franca:

<http://www.csa.fr>

http://www.csa.fr/actualite/communiqués/communiqués_detail.php?id=127231

Gjermania:

<http://www.alm.de>

http://www.alm.de/fileadmin/forschungsprojekte/GSDZ/Neu_Digitisation_2007.pdf

http://ec.europa.eu/information_society/policy/ecom/doc/todays_framework/digital_broadcasting/switchover/de_a_nlage2_bericht_digrf_eeurope_en.doc

Italia:

<http://www.agcom.it>

http://ec.europa.eu/information_society/policy/ecom/doc/todays_framework/digital_broadcasting/switchover/it_digital_sw_it_rev1_en.doc

Hulumtimi u realizua nga Kompania hulumtuese MPR Group:

Veton Latifi, PhD – Udhëheqës i ekipit

Agim Zuzaku

Valeza Islami

Gjithashtu edhe ekipi më i gjerë i MPR Group që ka ofruar



mprgroup
